



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.5/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Rustem Thaqi, anëtar, në çështjen disiplinore, ndaj Rr.P., P në P Th në P., kundër Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë (KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës, kundër vendimit të KPK-së, nr.56/2024, të datës 15 janar 2024, në seancën e mbajtur me datë 28 Shkurt 2024, kolegji merr;

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e paraqitur nga Rr.P., P në P Th në P., ndërsa vendimi i Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës në Prishtinë, KPK/nr.56/2024, i datës 15 janar 2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, (KPK), me vendimin KPK/nr.56/2024, të datës 15 janar 2024, në pikën I., të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet Raporti i Panelit Hetimor AD.nr..., i datës 24 nëntor 2023, në rastin disiplinor ndaj prokurorit Rr.P., Prokuroria Themelore në P.,. Në pikën II., vërtetohet se prokurori Rr.P., ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën III., të dispozitivit prokurorit Rr.P., i shqiptohet sanksioni disiplinor, “Vërejtje publike me shkrim”, në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër vendimit KPK/nr.56/2024, të datës 15 janar 2024, prokurori Rr.P., në afat ligjor ka paraqitur ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; zbatimit të gabuar të ligjit, për shkak shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj, dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që: Gjykata e Supreme e Republikës së Kosovës ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e tij, kurse vendimin e ankimuar, KPK.nr.56/2024, të datës 15 janar 2024, të Këshillit Prokurorial të Kosovës ta anuloj.

Me përgjigje në ankesë, KPK ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet ndërsa vendimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KPK, nga Autoriteti Kompetent Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. K.M, më datë 26 shtator 2023, ka pranuar kërkesën AD nr. 29/2023, për fillimin e hetimit disiplinor kundër Prokurorit z. Rr. P, lidhur me mos trajtimin e rastit RN.II.nr.520/18, prej pranimin të kësaj lënde me datë 14 mars 2018, të raportuar nga O.F të K., për falsifikim të dokumentit, duke mos ndërmarrë veprime konkrete kompetente prokuroriale sipas kompetencës së prokurorit të shtetit dhe ligjit e deri në paraqitjen e ankesës së O. F.K., në vitin 2023. Autoriteti kompetent pretendon se në këtë rast ka bazë të dyshimit të arsyeshëm që prokurori në fjalë me këtë ka bërë shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.4, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, andaj i ka rekomanduar KPK, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor në mbështetje të nenit 12 par. 2, Ligjit të njëjtë dhe nenit 8 par. 2 të Rreg. për Procedurën Disiplinore për Prokuror nr. 05/2019, dhe prokurorit Rr. P ti shqiptoj sanksion disiplinor, “ Vërejtje jo publike me shkrim”, e përcaktuar me nenin 7, paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me vendimin KPK-nr.716/2023, të datës 29 shtator 2023, themelon Panelin Hetimor për lëndën disiplinore-rasti, AD.nr.29/2023. Paneli Hetimor, fillimisht bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 06/L-057 dhe nenit 47, të Rreg. nr. 05/19 për procedurën disiplinore të prokurorëve kishte propozuar marrëveshje vullnetare për zgjidhjen e kësaj çështje mirëpo këtë e kishte refuzuar subjekti nën hetim. Nga Paneli hetimor me 24.09.2023, KPK ka pranuar raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar, nga ka rezultuar se nga provat e paraqitura është arrit në përfundim se prokurori Rr. P ka vepruar në shkelje të nenit 6 par. 2, nën par. 2.1, dhe 2.4., të Ligjit 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse nuk ka ndërmarr asnjë veprim konkret procedural, nuk ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, prej periudhës së paraqitjes së rastit me dt. 14 mars 2018, deri në kohën e ankesës së paraqitur nga O. F., (periudhë pesë vjeçare), asnjëherë nga palët nuk e ka dëgjuar ,edhe përkundër ekzistimit të dyshimit të bazuar në prova se është kryer vepra penale e falsifikimit të dokumentit nga neni 398 të KP-së.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur 22. Dhjetor 2023, hapë seancë disiplinore ndaj subjektit të hetimit, për deri sa i njëjti nuk paraqitet në seancë, përkundër

pranimi të ftesës në mënyrë të rregullt. KPK, mbanë seancë shtesë si në kuptim të nenit 14 par.1 të Ligjit nr. 06/L-057, me datë 15 janar 2024, dhe pas shqyrtimit të raportit të panelit hetimor, dëgjimit të raportimit të kryesuesit të panelit dhe subjektit të hetimit dhe vlerësimit të gjithë provave të mbledhura në procedurë hetimore, nxjerrë vendimin e atakuar KPK.nr.56/2024 me dt. 15 janar 2024, me të cilin prokurori Rr.P., shpallet përgjegjës për shkelje disiplinore për rastin AD.nr.29/2023 dhe i shqiptohet sanksioni disiplinor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar, të cituar si më lartë në paragraf një të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të vendimit të tij KPK-ja ndër të tjera arsyeton se; pas analizimit të kësaj çështje në tërësi me shumicë votash erdhi në përfundim se prokurori në fjalë ka bërë shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak se pavarësisht se lënda e pranuar nga ai ka qenë RN, i njëjti nuk ka vepruar në drejtim të zbardhjes së kësaj çështje juridike penale sipas kompetencës së prokurorit të shtetit duke e neglizhuar si rast, dhe duke mos marrë asnjë veprim procedural , nuk nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve ,nuk i ka dëgjuar palët, andaj për këtë i shqiptohet sanksioni ,”vërejtje publike me shkrim, “ e cila është në përputhje me të gjeturat si në raportin e panelit, dhe rrethanat që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në me të shkeljes disiplinore dhe masës së shqiptuar ,duke u marrë për bazë pasojat shkeljes disiplinore , rrethanat nën të cilat është kryer shkelja disiplinore, sjellja e subjektit nën hetim, bashkëpunimi në procedurën disiplinore dhe masa disiplinore e shqiptuar më herët, ”vërejtja jo publike me shkrim”, me vendimin, KPK/nr. 257/2023 e dt. 23 03.2023.

Mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar, KPK-ja i është referuar nenit 6 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.4, lidhur shkeljen disiplinore të vërtetuar, dhe masa disiplinore i është shqiptuar konform nenit 7 parag.1.,pika 1.2, të Ligjit nr. 06/L057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejt dhe në mënyrë plotë është vërtetuar gjendja faktike, në mënyrë të drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as më shkelje tjera, si pretendon pala ankuese me ankesë.

Subjekti hetimor në ankesën e paraqitur pretendon se, në rastin konkret, “ Rast i Ndryshëm, nuk ka pas kallëzim penal, se në rastin në fjalë është kërkuar urdhëresa për ekzaminim dhe se lënda automatikisht arkivohet në arkiv dhe se lëndët e tilla nuk futen as në sistemin SMIL, se në këto lëndë nuk vendoset në mënyrë meritore, për deri sa në rastin konkret ishte bërë ekspertimi dhe ishte dhënë konstatimi dhe mendimi përfundimtar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë sipas raportit të dt. 05.8.2019, dhe ishte konstatuar se i dyshuari nuk kishte ndërhyrë në manipulim-falsifikim të kontratës.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara për faktin se këto pretendime dhe të tjerat në ankesë nuk janë të bazuara në prova dhe fakte në baza ligjore që do të përjashtonin përgjegjësinë e tij, për veprën e cila i ngarkohet, neglizhencë e kryerjes së detyrave të punës dhe është shpallur përgjegjës, sepse prej pranimit të lëndës, “Rast i Ndryshëm”, RN II.nr. 520/2023, me dt. 14 mars 2018, e deri në inicimin e procedurës disiplinore nuk ka ndërmarrë veprime konkrete prokuroriale sipas kompetencës së prokurorit të shtetit, në drejtim të zbardhjes së kësaj çështje juridike penale, duke mos ndërmarrë asnjë verim procedural, nuk nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve, nuk ka bërë dëgjimin e palëve, për kundër ekzistimit të dyshimit të bazuar në bazë të provave në shkresa të lëndës, dy kontratave të dyshimta të punës se është kryer vepra penale e falsifikimit të dokumentit nga nenin 398 i KPRK-së, fakte këto që provohen nga raporti i panelit hetimor AD nr. 29/23, dhe provave të administruara nga KPK si në vendimin e tij, nga ka rezultuar se subjekti nën hetim ka kryer shkelje disiplinore.

Gjykata Supreme vlerëson se procedura e zhvilluar në këtë çështje ka garantuar objektivitetin e procesit të hetimit, vlerësimin dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të gjitha kërkesave dhe pretendimeve si në aspektin procedural por edhe në aspektin e zbatimit të drejtës materiale. Vendimi i atakuar i KPK është i qartë, i rregullt në strukturë dhe përmbajtje. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka arsyetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, nga me të drejtë ka ardhur në përfundim se prokurori R.P., për rastin AD.nr.29/2023 ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të cekur si në dispozitiv të vendimit të KPK. Andaj nga theksimet si më lartë rezulton se në këtë çështje nuk rezulton se KPK ka bërë zbatim të gabuar të ligjit apo vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ashtu si theksohet në ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e KPK-së, për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se me nenin 6 paragraf 2 nën paragraf 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “ *Shkelja e detyrave të prokurorit sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se prokurori kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë: “në mënyrë të vazhdueshme nuk ndërmerr ndonjë veprim prokurorial që kërkohet me ligjin në fuqi ose nuk ushtron funksionet prokuroriale brenda afateve kohore të parapara me ligj, përveç nëse serioziteti i mos veprimit apo niveli i shkeljes paraqet bazë për inicimin e procedurës disiplinore për një shkelje të vetme”*. Ndërsa me paragrafin 2.4, të njëjtit nen si shkelje e detyrave të prokurorit përcaktohet se : “ *nuk siguron se dëshmitë dhe faktet gjat hetimeve mbliidhen në përputhje me ligjin në fuqi. Me nenin 7 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike*

me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ultë; 1.5. propozim për shkarkim ”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se; “Masa disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performanca dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KPK, drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e prokurorit në procedurë nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i ka shqiptuar sanksionin disiplinor. Po ashtu, Gjykata Supreme vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KPK, është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit, për faktin se me rastin e vendosjes ka marrë parasysh, seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilën është kryer shkelja disiplinore, sjellja e subjektit nën hetim, performanca dhe bashkëpunimi në procedurën disiplinore dhe masa disiplinore e shqiptuar më herët, ”vërejtja jo publike me shkrim”, me vendimin, KPK/nr. 257/2023 e dt. 23.03.2023, rrethana këto që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit, në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, të shqiptuar siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e cekura si më lartë Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në mbështetje të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË

A.A.nr 5/2024, me datë 28.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani